



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Pml.nr.727/2024

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar i kolegjit, Rasim Rasimi dhe Afrim Shala, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit S. Sh.nga P., për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 421 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.335/2023 të datës 14.03.2024 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.339/2024 të datës 29.07.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 05.12.2024, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit S. Sh. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.335/2023 të datës 14.03.2024 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.339/2024 të datës 29.07.2024.

### A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, P.nr.335/2023 datë 14.03.2024, i dënuari S. Sh. është shpallur fajtor për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 421 par.1 të KPRK-së dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë, si dhe me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilin dënim me gjobë i dënuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, e në rast se i dënuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, dënimi me gjobë i zëvendësohet me dënim me burgim duke ia llogaritur për çdo 20 € të gjobës me një ditë burgim. Në dënimin e

shqiptuar me burgim i llogaritet edhe koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak nga data 30.04.2022 deri më 29.07.2022.

Të dënuarit konform nenit 59 par.1 dhe par.2, nënpar.2.3 të KPRK-së, i është shqiptuar dënimi plotësues, ndalimi i ushtrimit të profesionit në administratën publike ose në shërbimin publik në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, pas mbajtjes dhe ekzekutimit të dënimit me burgim.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.339/2024 e datës 29.07.2024, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të dënuarit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit S. Sh., avokati Flamur Bllacaku, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, shkeljes së nenit 31 dhe nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6 të KEDNJ, me propozim që kërkesa të aprovohet si e bazuara ndërsa aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Prokurori i shtetit të Kosovës në Prishtinë, me parashtrësën KMLP.II.nr.413/2024 e datës 02.12.2024, ka paraqitur përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, me propozim që kërkesa e mbrojtësit të dënuarit të refuzohet si e pabazuar.

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësi i të dënuarit pretendon se, aktgjykimet e kundërshtuara janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sepse aktgjykimet nuk kanë vlerësuar me saktësi provat kundërtënëse si dhe ekziston kundërthënie në mes të asaj që theksohet në aktgjykim lidhur me përmbajtjen e provave materiale dhe personale të administruara nga gjykata e shkallës së parë, si dhe gjykata në aktgjykimin me të cilin e ka shpallur fajtor të dënuarin S. Sh. nuk i ka cekur fare faktet kontestuese mbi bazën e të cilave është dënuar i dënuari, i cili vendim sipas mbrojtjes ka qenë jo i drejtë, duke mos pasur prova të pranueshme, po ashtu nuk ka paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit.

Më tutje në kërkesën e mbrojtësit të dënuarit theksohet se, me aktgjykimet e kundërshtuara janë shkelur dispozitat e nenit 3 par.2 të KPP-së, pra është cenuar parimi in dubio pro reo, sepse gjykata ka shpallur fajtor të dënuarin duke u mbështetur në fakte apo në dyshime të paprovuara, e të cilat duhet të çmohen në favor të dënuarit, pastaj janë shkelur dispozitat e KPP-së të cilat ndalojnë që aktgjykimi të mbështetet në provë të papranueshme, siç është në rastin konkret, dëshmia e bashkë të pandehurit dhe video incizimet e pa konfirmuara.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPP-së, dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësit të dënuarit janë të pabazuara, meqë aktgjykimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa, nuk përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të ligjit penal.

Kështu në këtë çështje penalo juridike, dispozitivi i aktgjyimit të shkallës së parë është i qartë, konkret, i njëjti nuk përmban kundërthënie me vet veten e as me arsyetimin e tij, po ashtu i njëjti në përshkrimin faktik të veprës penale përmban të gjitha elementet objektive dhe subjektive të cilat përbëjnë figurën e veprës penale. Në arsyetimin e aktgjyimit të shkallës së parë dhe aktgjyimit të shkallës së dytë janë paraqitur të gjitha arsyet për faktet vendimtare të cilat janë paraqitur qartë dhe me asnjë mënyrë nuk paraqiten si kundërthënës.

Dispozitivi i aktgjyimit të shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë është i kuptueshëm, i qartë dhe konkret, si dhe në përputhshmëri të plotë me arsyetimin, përpilimi i të cilave është bërë konform dispozitave të nenit 369 par.4 lidhur me nenin 364 të KPP-së, ku janë përfshirë të gjitha faktet dhe rrethanat nga të cilat, plotësohen të gjitha elementet e veprës penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor. Në arsyetimin e aktgjyimeve janë dhënë arsyet e duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje penale, duke u bazuar në dispozitat e nenit 369 par.6 të KPP-së, ku gjykata e shkallës së parë ka paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjyimit, si ato faktike ashtu edhe ato juridike. Po ashtu janë dhënë arsye të mjaftueshme faktike dhe juridike, duke shpjeguar qartë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i merr si të provuara ose të paprovuara, duke bërë kështu vlerësimin e provave kontradiktore konform nenit 369 par.7 të KPP-së.

Gjykata e shkallës së parë ka bërë vlerësimin e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke i paraqitur lidhur me këto konkludimet, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë. Arsyet të cilat i ka dhënë gjykata e shkallës së parë, kanë mbështetje në provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor, dhe atë në deklaratën e të dëshmitarit R. D.- i cili ka qenë vozitës i autobusit dhe kur është ndalur nga tani i dënuari S. i është marrur librezja e qarkullimit të automjetit dhe se librezja nuk është dorëzuar në stacion policor nga i pandehuri S., e din se i dënuari ka kërkuar shumën prej 50 € për ta kthyer librezën dhe nuk e din se si ka ra në kontakt vëllai H. por e din se ka shkuar dhe ia ka dhënë 50 € dhe e ka marr librezën. Përveç dëshmisë së dëshmitarit R. gjykata në shqyrtimin gjyqësor ka administruar edhe provat tjera ka dëgjuar dëshmitarët M. B., F. R. dhe provat tjera materiale.

Pretendimet e mbrojtjes se aktgjykimi është mbështetur vetëm në një deklaratë janë të pabazuara dhe nga shkresat e lëndës nuk rezulton se aktgjykimi mbështetet vetën në një deklaratë por rezulton se faktet janë provuar nga tërësia e provave që janë administruar në shqyrtimin gjyqësor, prandaj çështja e vlerësimit të deklaratës së dëshmitarit R. D. është një nga provat që ka të bëjë me vlerësimin që i ka bërë gjykata për të vërtetuar rrethanat e fakteve.

Sa i përket pretendimit të mbrojtjes që e ndërlidh të pandehurin H. D. cili ka qenë i bashkëpandehur në këtë rast, se është shkelur neni 119 par.5 të KPP-së, pretendimi është i pabazuar për faktin se i akuzuari H. D. ka qenë i akuzuar për veprën penale dhënie të rryshfetit

ndërsa i dënuari S. Sh. është akuzuar për veprën penale marrje ryshfeti, nga kjo rezulton se dy të pandehurit kanë qenë formalisht të proceduar me një aktakuzë, mirëpo i pandehuri H. D. nuk është marr në pyetje në cilësinë e dëshmitarit, prandaj kjo gjykatë vlerëson se nuk është cenuar neni 119 par.5 duke qenë se deklarata e të pandehurit H. nuk është vlerësuar në raport me rrethanat e fakteve që i vishen të dënuarit S..

Lidhur me pretendimet e mbrojtjes sa i përket video incizimit, kjo gjykatë vlerëson se kemi të bëjmë me incizime që rezultojnë se janë marr nga kamerat e Stacionit Policor në Veri e që vërtetohen nga shkresat e kallëzimit penal të zyrtarëve policor, prandaj pretendimi se prova nuk është marr në mënyrë të ligjshme dhe se është e manipuluar është e pabazuar, ngase rezulton nga video incizimi ku shihet i dënuari S. kur është takuar me të pandehurin H. para stacionit policor në Veri.

Nga vet deklarata e të dënuarit provohen faktet se i dënuari ditën kritike ishte në ushtrimin e detyrave të tij si zyrtar policor, se ai ka ndalur autobusin, se ia kishte marr librezën e qarkullimit drejtuesit të autobusit R. D. dhe se librezën e qarkullimit ia kishte kthyer vetëm kur ishte paraqitur H. D. para Stacionit të Policisë.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se dy gjykatat e instancave më të ulëta drejt kanë konkluduar se nga tërësia e provave të administruara është vërtetuar se i dënuari S. ka marr shumën prej 50 € duke shfrytëzuar pozitën e tij si zyrtar policor, ku edhe ja ka kthyer librezën e qarkullimit pasi që paraprakisht me rastin e ndalimit në komunikacion ia kishte marr drejtuesit të autobusit librezën e qarkullimit të automjetit. Drejt ka gjetur gjykata e instancës më të ulët, se me rastin e shkeljes në komunikacion të mosrespektimit të shenjës së komunikacionit nga drejtuesi i autobusit, i dënuari si zyrtar policor nuk kishte shqiptuar as gjobë dhe as vërejtje për shkelje të rregullave në komunikacion, mirëpo kishte marr dokumentin e qarkullimit të autobusit, nga ana tjetër i njëjti përveç që ka marr dokumentin e qarkullimit i njëjti nuk kishte zbatuar procedurën standarde të evidentimit dhe dorëzimit të këtij dokumenti në polici por e kishte mbajtur me vete.

Prandaj nga të gjitha të cekurat si më lartë kjo gjykatë vlerëson se pretendimet e mbrojtësit të dënuarit janë të pabazuara dhe si të tilla nuk gjejnë mbështetje dhe janë në kundërshtim të plotë me të gjitha provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor nga gjykata e shkallës së parë, e posaçërisht me dëshmitë e dëshmitarëve M. B., R. D. dhe F. R., e po ashtu edhe provave tjera materiale dhe pjesërisht edhe me vetë mbrojtjen e të dënuarit të dhënë në shqyrtimin gjyqësor, kjo për faktin se dëshmitari R. D., në mënyrë të qartë e ka pohuar faktin se i dënuari S. Sh. ka marr ryshfet, me rastin kur e ka dorëzuar librezën e autobusit, e njëkohësisht këtë e vërteton edhe video incizimi, ku shihet se i dënuari para stacionit policor është takuar me dhënësin e ryshfetit, ku me atë rast ia ka dhënë librezën dhe nga i njëjti e ka marr shumën e parasë.

Gjithashtu, Gjykata Supreme e Kosovës e konsideron të pabazuar edhe pretendimin e mbrojtësit të të dënuarit S. Sh. që ndërlidhet me parimin “In Dubio Pro Reo”, sipas nenit 3, par.2 të KPP-së, pasi që në këtë rast nuk ekziston asnjë mëdyshje lidhur me ekzistimin e fakteve të

rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal që ndërlidhet me veprën penale dhe përgjegjësinë penale të të dënuarit. Nga aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë shihet se janë paraqitur arsye të mjaftueshme në lidhje me të gjitha aspektet relevante të kësaj çështje penale, kështu që nuk janë vërejtur mëdyshje që ndërlidhet me këtë rast apo me zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal e që ka të bëjë me të dënuarin S. Sh..

Prandaj, në bazë të paraqiturave më lartë, rezulton se në veprimet inkriminuese të të dënuarit S. Sh., përmbushen të gjitha elementet e veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 421 par.1 të KPRK-së, të përshkruara si në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë, ku i dënuari duke e shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar nuk i ka përmbushur detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër në atë mënyrë që i dënuari, i vetëdijshëm për veprën e vet dhe duke dëshiruar kryerjen e saj, në cilësinë e personit zyrtar si zyrtar policor, me datën 28.04.2022 në mënyrë të drejtpërdrejtë përmes telefonit duke e telefonuar të pandehurin H. D. kishte kërkuar ryshfet shumën prej 50 € për vete me qëllim që dhënësit të ryshfetit t'ia kthen librezën e qarkullimit të autobusit të markës S., për çka nuk janë të bazuara as pretendimet për shkeljen e ligjit penal.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerësoj se aktgjykimet e kundërshtuara nuk përmbajnë shkeljen e ligjit penal dhe shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat në kërkesë pretendohen dhe në kuptim të nenit 437 par.1 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.727/2024, më datë 05.12.2024

Procesmbajtësi,  
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,  
Agim Maliqi